

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 248 /2025

Datë: 30/04 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK - nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, në pajtim me nenin 3 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15.4) dhe nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Rregullores nr. 01/2019 menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ministria në detyrë e Drejtësisë, si udhëheqëse e sektorit të subjektit publik (SSP), nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 28/2025 të datës 27/01/2025, për delegimin e autorizimeve për zyrtar autorizues për menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve dhe pasurisë

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2 (pika 2.4) e vendimit nr. 28/2025 të datës 27/01/2025 si në vijim:

2.4 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar - Alban Sutaj, U.D. Drejtor i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m


Me vendimin nr. 184/2025, të dates, 11.04.2025, z. Alban Sutaj është caktuar në pozitën Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar.

Andaj, me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor që rrjedh nga legjislacioni përkatës në fuqi mbi kontrollin e brendshëm të financave publike dhe menaxhimin e tyre, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Z. Alban Sutaj;*
- *Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Prokurim publik;*
- *Arkivit të MD-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - MinistarsvoPravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelaria Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 184 /2025
Datë: 11/04 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M


1. Z. Alban Sutaj, nëpunës civil në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij t'i kryejë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi është gjashtë muaj (6) dhe fillon nga datë 14.04.2025.
4. Obligohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar për zbatimin e këtij vendimi.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 356/2024, i datës 09.10.2024.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU

Ministër në detyrë e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Alban Sutaj;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar;
- Arkivit e Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres-Kancelarija Ministra-Cabinet of the Minister

Nr. 28/2025
Datë: 27/01/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, në përputhje me nenin 3 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15.4) dhe nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, si dhe në përputhje me nenin 7 dhe 8 të Rregullores nr. 01/2019 menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ministria e Drejtësisë si udhëheqëse e sektorit të subjektit publik (SSP), nxjerr:

V E N D I M

Për delegimin e autorizimeve për zyrtar autorizues për menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve dhe pasurisë

1. Ministria e Drejtësisë – Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme
2. Agjencitë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, si në vijim:
 - 2.1 Shërbimi Korrektues i Kosovës – Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.2 Shërbimi Sprovues i Kosovës – Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.3 Instituti i Mjekësisë Ligjore – Ditor Haliti, Zv. Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.4 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar – Fadil Bunjaku, U.D. Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.5 Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë – Muamer Bikliqi, Zv. Kryeinspektor;
 - 2.6 Avokatura Shtetërore – Arsim Zuka, Zv. Avokat i Përgjithshëm Shtetëror
 - 2.7 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Faton Jashari, U.D. Drejtor Ekzekutiv
3. Zyrtarët e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij vendimi tek të cilët janë deleguar autorizimet, janë të obliguar që të veprojnë në harmoni me Ligjin përkatës mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin përkatës të Buxhetit, Ligjin përkatës të Prokurimit dhe dispozitat tjera përkatëse dhe të delegojnë autorizimet për menaxhimin financiar dhe kontrollin zyrtarëve përkatës të tyre.

4. Zyrtarët autorizues, të cilëve ju janë deleguar autorizimet, përveç autorizimeve sipas paragrafit 3, ju delegohen të gjitha autorizimet për menaxhimin e pasurisë jo financiare sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, neni 4, (pika 1, 2, 3 dhe 4), që të menaxhojnë pasurinë jo financiare për departamentet/divizionet/sektorët/programet të cilat i udhëheqin, në të gjitha aspektet, duke filluar nga autorizimi, pranimi, dhënia në shfrytëzim, kujdesi, mbajtja e evidencës, regjistrimi, vlerësimi pas amortizimit ekonomik apo shlyerjajtjetërsimi. Të gjitha veprimet, duhet të merren sipas ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Të lartpërmenduroe;*
- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretares të Përgjithshme;*
- *Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Prokurim Publik;*
- *Arkivit të MD-së.*